BESIMI TRIUMFON MBI "IDHUJTARINË" E SHOQËRISË!

DASHURIA DHE EDUKATA NDAJ PEJGAMBERIT (A.S)

MYFTIU: "SHTETI I KUVAJTIT, I DËSHMUAR PËR BAMIRËSI DHE HUMANIZËM!"

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 19 - Nr. 11 (225), Nëntor, 2021

www.myftinia-shkoder.org

MYFTINIASHKODER1990

"Lavdi të Madhit Zot, që e ruajti dashurinë e Tij në zemrat tona e nuk na përbuzi..!"

MYFTINIA SHKODËR URON 109 VJETORIN E PAVARËSISË

Ditën e diel, më 28 nëntor 2015, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i shoqëruar edhe nga teologët Lavdrim Hamja dhe Arben Halluni, mori pjesë në ceremoninë tradicionale që organizon Bashkia Shkodër me rastin e ngritjes së flamurit kombëtar, në këtë ditë të shënuar të pavarësisë.

Gjatë kësaj ceremonie, Myftiu Sytari uroi fillimisht Kryetaren e Bashkisë Shkodër, znj. Voltana Ademi, Kryetarin e Këshillit të Qarkut Shkodër, z. Hilmi Lakti, Prefekten...

(f. 17)

AKTIVITET PËRKUJTIMOR, 31 VJET SI SOT, NË XHAMINË E PLUMBIT...

Paradreken e të martës, më 16 nëntor 2021, në xhaminë e Plumbit u zhvillua një aktivitet përkujtimor në ditën e shënuar historike të ceremonisë madhështore të rihapjes së xhamisë së Plumbit, më 16 nëntorit 1990.

Besimtarë të shumtë, imamë dhe drejtues të institucioneve islame, kishin ardhur për të falur fillimisht namazin e drekës në xhaminë e Plumbit. Më pas, në oborrin e xhamisë u mbajt një tubim përkujtimor me përshëndetje...

(f. 15)

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

“AJO ÇFARË JU SHIHNI, ËSHTË DEVIJIMI I NJË YMETI..!”

Pasuesit e Librave të shenjtë (Ehli Kitabët) e devijuan Fjalën nga vendi i saj, në forma të caktuara. Ndërsa ne (muslimanët), në hapësirat e shekujve, e veshëm Shpalljen hyjnore me kapriçot tona, derisa humbi shkëlqimi i saj...

Sot, teksa analizoj me vëmendje realitetet e ngatërruara, nëpër të cilat kalon ymeti islam, goditjet e njëpasnjëshme që merr nga krejt anët, gjekaderdhja dhe dhuna e pësuar që e ka kapluar, etiketimet e padrejta dhe krejtësisht të pabaza që i adresohen, por edhe keqleximi që i bëjnë shumë të rinj fesë së tyre, larg edukimit, adhurimit, dijes dhe urtësisë, (si katër elementë thelbësorë në formimin e personalitetit të muslimanit), më vijnë ndër mend fjalët e dijetarit të urtë egjiptian, Shejkh Muhammed El-Gazali (1996-1917), kur thotë:

“Pasuesit e Librave të shenjtë (Ehli Kitabët) e devijuan Fjalën nga vendi i saj, në forma të caktuara. Ndërsa ne (muslimanët), në hapësirat e shekujve, e veshëm Shpalljen hyjnore me kapriçot tona, derisa humbi shkëlqimi i saj...

Gati-gati më bëhet t’i them, krejt banorëve të kontinenteve: Ajo që ju shihni në veprimet dhe sjelljet tona, nuk është ajo që ka shpallur Allahu në Libër, as shembulli i dëshmuar nga i Dërguari i Tij në sjelljet e tij!

Ajo çfarë ju shihni, është devijimi i një ymeti, që ka harruar se çfarë posedon dhe ecën përpara me tekat e tij!”

Me fjalë të tjera, mos të tundohet njeri nga mashtrimet dhe iluzioneve optike, që krijojnë skenografitë e ngarkuara me mallra të riciklueshme, as mos të devijojë dikush nga padija dhe çoroditja e kujtdo që pretendon besimin dhe fenë, ndërkohë që besimi dhe feja e vërtetë ndodhen diku e, ata, pretenduesit e ekzaltuar, diku tjetër!

BESIMI TRIUMFON MBI “IDHUJTARINË” E SHOQËRISË!

Ata ishin një grup të rinjsh besimtarë në një shoqëri idhujtare. Sinqeritetin e tyre në raport me besimin, Allahu i Madhëruar e përjetësoi në Kuran, që lexohet deri në kijamet!

Çdo javë e lexojmë dhe e rilexojmë atë sure të begatë, sipas porosisë së Resulullahut (paqja qoftë mbi të), porse a përpiqemi sadopak të kuptojmë mesazhet që ajo na përcjell, që të mbetemi përherë në shinat e Nurit të premtuar në dëshminë e Pejgamberit (a.s)?

Përse u përjetësua shembulli i të rinjve besimtarë, që nuk e shitën fenë e besën e Zotit përpara hirtësisë së realiteteve të vulosura me idhujtari?

Nga ana tjetër, a mundemi sot, të kapërcejmë hendeqe të ndryshme, me të cilat përballemi në jetë dhe që kanë në thelb prekjen e nervit të besimit e fetarizmit të shëndoshë, që ndërton dhe krijon siguri në jetë?

Dorëzoja veten Allahut dhe mos lejo asgjë në botë ta prekë kalanë e sinqeritetit! Le ta godasin, le ta sulmojnë, por kurrë mos lejo ta mposhtin!

Mos prit shpërblimin a vlerësimin e dikujt prej racës njerëzore për veprën tënde, bëje të mirën për hatrin e Zotit tënd, Atij kushtoja, dhe mos harro se shirku është zullum i madh!

Jeto me besim dhe krijo modele për t’u pasuar me moralin dhe gjendjen tënde, me fjalën dhe mirësjelljen tënde, me korrektësinë dhe aftësitë e tua, me altruizmin dhe bamirësinë tënde, me kurajon dhe vullnetin për të dëshmuar dritën e besimit dhe mrekullitë e tij!

Të rinjtë e “Shpellës”, të përjetësuar në suren “El-Kehf”, mbeten yje udhëzimi në përmbajtjen e forcës së besimit, për çdo të ri e të re, që rrezikohen sot nga idhujtaria moderne, nga shthurja morale, nga mbytja e kohës, nga eliminimi i pozitës së familjes, nga prishja e ekuilibrave të natyrshmërisë, në të cilën Zoti na krijoi, nga përzierja e koncepteve dhe ndërhyrja zhurmuese në thelbin e botëkuptimeve, duke nisur me atë të fesë..!

Aman, 25 nëntor 2017
Shkodër, 17 tetor 2021

HOMAZH PËR NJË BURRË ME LETRA SHUMË..!

Ndërroi jetë studiuesi Smajl Bala!

Myftinia Shkodër i shpreh ngushëllime të përzemërta familjes, miqve dhe kolegëve të tij!

Për herë të parë, zotni Smajlin e kam takuar para më shumë se një dekade. Atë ditë (e kujtoj mirë, ishte e xhuma), po kthehesha nga xhamia e Tophanës, pasi kisha përfunduar hytben dhe namazin e xhumasë.

Afër hyrjes së shtëpisë, ku banoja, një burrë i panjohur, me flokë të bardha e me një tufë letrash në dorë, më drejtohet me selam e përshëndetje...

Nga ajo ditë, kaluan vite e vite, përgjatë të cilave u takuam me dhjetëra herë, në biseda, takime, promovime e diskutime që lidhen me librat, studimet, kulturën, botën e letrave dhe gjurmët e arkivave, ku zotni Smajli spikaste për durimin dhe këmbënguljen e tij të çuditshme!

Libri i tij për hoxhallarët dhe institucionet islame të Shkodrës, për të cilin kam shkruar dhe i kam dhënë mendimet e mia me shumë kujdes, u pasua nga botime të tjera, që përtej detajeve të përmbajtjes, i bënë nder shumë institucioneve në Shkodër, për arkivat dhe historikun e të cilëve u përkujdes me shumë fanatizëm autori Smajl Bala, edhe pse, në të shumtën e rasteve nuk i përkiste atyre fushave dhe institucioneve; botëkuptimit, formimit dhe vizionit, porse dëshira e tij për të mos ngelur pasiv na bëri dëshmitarë të botimeve të njëpasnjëshme që mbajnë firmën e tij.

I fundit i kësaj kolane (nëse vlen ta quaj kështu për natyrën e punimeve të tij), ishte libri për medresenë e Shkodrës në 30 vjetorin e saj, për të cilin nisa të shkruaj kritikat e mia, mendimet dhe vështrimet, por sëmundja e tij e ditëve të fundit dhe angazhimet e mia, më penguan dhe u bënë mur ndarës në mes meje dhe shënimeve rreth atij botimi, që gjithsesi mbetet edhe një ftesë morale për vetë medresenë, drejtuesit e saj dhe krejt ne në hak të borxhit të madh përkarshi historikut real të këtij institucioni, peshës, gjurmëve dhe misionit, zhveshur nga konjukturat dhe vështrimet e ngushta mbytëse!

Herën e fundit që u pamë, ai sërish mbante në dorë një tufë letra, porse kësaj radhe të lidhura e të sistemuara në një libër, të fundit botim që pa në këtë botë e me kujtimin e të cilit u nda nga kjo jetë, duke marrë me vete bagazhin e nijeteve, veprave dhe kontributeve të tij, për të cilat lutem me zemër që t’i gjejë dritë e bekim në të përtejmen!

Ashtu, i hajthëm e këmbëngulës, me çantën plot shënime e letra, plot copëza arkivash e emra të përveçëm bashkë me foto e kujtime, dhe mbi të gjitha, dëshirën e pashembullt për të punuar, zotni Smajl Bala u largua nga kjo jetë duke lënë pas emrin, që do i lexohet e kujtohet, sa herë që të do shfletohen librat e botimet e tij, por jo vetëm..!

Rahmet pastë!

Imam Muhamed B. Sytari
Shkodër, 7 nëntor 2021

Dr. Mustafa Mahmud
(1921 - 2009)

“

"Fatkeqësia e kësaj kohe është mungesa e moralit, mungesa e fesë, lënia pas e rolit të mbikëqyrjes së familjes dhe mungesa e ekzistencës së shembullit në shtëpi, në shkollë dhe në universitet;

Egërsia e materies, mbizotërimi i lakmisë, pangopësia, adhurimi i pasurisë, i më të fortit dhe i atij që ka më shumë pushtet, edhe sikur të jetë hajdut pa pikë ndërgjegje!

Adhurimi i pamjes së jashtme, hipokrizia e pushtetit dhe ecja në karvanin e pushtetarëve;

Globalizmi i iluzioneve, gjërave të kota dhe nxitjes së epsheve në çdo mjet informacioni;

Të tëra këto zanafilla, na kanë çuar drejt fesadit (prishjes), prej të cilit po vuajmë".

”

INTERVISTË E MYFTIUT TË SHKODRËS PËR VOA, ME RASTIN E 31 VJETORIT TË RIHAPJES SË XHAMISË SË PLUMBIT

Sfidat e shumta me të cilat përballemi sot, mund të përmendim atë që është edhe çështje e ditës, thirrjet për të ndryshuar dhe për të prekur kodin e familjes që ne si komunitet besimtar, pra myslimanë, të krishterë por jo vetëm, jemi dorë për dore dhe thërrasim drejt respektimit të tabanit tonë fetar dhe kombëtar sikurse thërrasim që të mos preket kodi i familjes sepse familja është gjëja më e shenjtë që kemi në jetën tonë!

16 Nëntori i vitit 1990 është patjetër një ngjarje e shënuar, një datë historike kombëtare për krejt shqiptarët, sikurse dhe datat e rihapjes së institucioneve të tjera fetare; të kishave në qytetin tonë, janë data historike të shënuara në historinë tonë kombëtare, janë data që na lidhin përherë e më tepër me gjurmët e të parëve tanë që jetuan në harmoni me njëri-tjetrin dhe na lanë një trashëgimi të mrekullueshme të besimit, të qytetarisë, të tabanit të fortë kombëtar që mbështetet në besimin dhe mundëson që njeriu të jetojë me të mirën e mënyrave duke dëshmuar bekimet e Zotit dhe mëshirën e Tij në jetën e përditshme.

Në të sotmen, 16 nëntor 2021, pra 31 vite më tej, ne natyrshëm që jemi të ftuar për të reflektuar dhe për të medituar rreth mesazheve të rëndësishme që përcjell rihapja e institucioneve tona fetare, liria e besimit që është ndër vlerat themelore dhe ndër shenjtëritë e njeriut, ashtu sikurse thoshte edhe Hafiz Sabri Koçi para 31 vitesh, "njerëzit t'i lënë të lirë të besojnë", dikush mund të besojë dhe dikush nuk beson, ama njeriu është i lirë, dhe natyrshëm që rikthimi i lirisë së besimit dhe i lirive në përgjithësi në vendin tonë pas sa e sa vitesh nën diktaturë është një ogur i mirë dhe një sihariq i madh për krejt kombin.

Sfidat e shumta me të cilat përballemi sot, mund të përmendim atë që është edhe çështje e ditës, thirrjet për të ndryshuar dhe për të prekur kodin e familjes që ne si komunitet besimtar, pra myslimanë, të krishterë por jo vetëm, jemi dorë për dore dhe thërrasim drejt respektimit të tabanit tonë fetar dhe kombëtar sikurse thërrasim që të mos preket kodi i familjes sepse familja është gjëja më e shenjtë që kemi në jetën tonë!

Përveç kësaj, ashtu sikurse e kemi dëshmuar dhe e kemi përmendur në tubime të shumta ndërfetare, janë problematikat, me të cilat përballet rinia në veçanti, përhapja e bimëve narkotike, droga, shkelja e të drejtave të njeriut në aspekte dhe fusha të ndryshme, varfëria, mjerimi, skamja, emigracioni e kështu me radhë.

Unë besoj dhe mendoj se komunitetet fetare kanë qenë në krye të shoqërisë duke dëshmuar më të mirën, duke dëshmuar vlerat e tyre!

"Erdogan i shpall luftë fajdeve (kamatës) dhe i konsideron ato si sëmundje dhe nëna e të gjitha të këqijave. Pavarësisht dimensionin lokal, ajo është luftë kundër sistemit botëror financiar, i cili mbështetet tek fajdet.

Në anën tjetër, spekulimet ndaj lirës turke janë shtuar dhe vlera e saj po bie kundrejt monedhave kryesore. Kush do të fitojë në këtë luftë vendimtare: Erdogani apo fajdexhinjtë?"

Ahmed Mensur
gazetar i shquar në rrjetin televiziv Al-Xhezira "Aljazeera"

MYFTIU: "31 VITE, KOHA PËR TË PARË VETEN NË PASQYRË, SI BASHKËSI E SI KOMUNITET!"

Është paradoks i madh dhe çudi e pashembullt, të shohësh sot një garim të frikshëm të disave që kanë pranuar të shesin dinjitetin dhe besimin, shenjtëritë dhe tabanin, për të arritur ndryshimin e kodit të familjes, për të prishur arshin e dashnisë dhe pozitës së naltë, ku Zoti ka vendos prindin: Nanen dhe Baben, për t'i kthyer ata në numra?!

Nëpërmjet minberit të xhamisë së Parrucës, të xhumanë, më 12 nëntor 2021, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, u përqendrua tek mesazhet e ceremonisë historike të rihapjes së xhamisë së parë në Shqipëri, 23 vite pas diktaturës ateo-komuniste, pikërisht më 16 nëntor 1990.



Në hytben e tij, Myftiu bëri një homazh dhe lutje për Hafiz Sabri Koçin, por edhe për hoxhallarët e shkuar, baballarët dhe besimtarët e sprovuar gjatë periudhës së komunizmit.

Myftiu tha se është koha të pyesim veten se ku jemi sot, pas 31 vitesh nga ajo ditë fatlume dhe se çfarë përgjegjësishë duhet të mbajmë mbi supe, si bashkësi e komunitet vlerash, që nuk duhet të pajtohet me këtë nivel e realitet ku ndodhet sot!

"A funksionon si duhet xhamia shqiptare, sot? A kemi ne myftini dhe myftilerë, xhami dhe imamë, medrese dhe mësues, vaize dhe predikuese, thirrës e thirrëse, që e kanë kuptuar thelbin e vetë Thirrjes Islame, që mbushin me plot gojë hapësirat ku shërbejnë, që i japin hakun kohës dhe përgjegjësive, që janë kudo me njerëzit, që ndjekin zhvillimet e realiteteve, që janë të vëmendshëm për axhendat drejt të cilave rrugëton vendi dhe kombi, që nuk lejojnë të nëpërkëmben, as të bien në batakun e sektarizmave të devijuara, thirrjeve dhe projekteve bashkëkohore që e duan Islamin si një rrymë pacifiste pa nerv e pa damar që rreh, si përbërës të një përzierjeje të re që prezantohet dhe reklamohet përherë e më shumë, si: "ibrahimizmi", që s'është as fé, as moral, as liri besimi, si dinjitet, as udhëzim, veçse degradim e shthurje, poshtërim dhe devijim nga boshti dhe thelbi të të vërtetës?!", – tha ndër të tjera Myftiu.

Në hytben e tij të kësaj jave, Imam Sytari iu qas edhe zhurmës së madhe mediatike që po ndodh këto ditë rreth tendencave për ndryshimin e kodit të familjes dhe miratimin e ligjeve të reja që devijojnë nga boshti i besimit dhe tabanit kombëtar.

"Dhe ejani pak të hedhim sytë nga shoqëria e jonë dhe të ndalemi tek tendenca e çuditshme dhe paradoksale për të prekur edhe rrënjët e tabanit dhe thelbin e organizimeve shoqërore, familjen dhe kodet s saj!

Është paradoks i madh dhe çudi e pashembullt, të shohësh sot një garim të frikshëm të disave që kanë pranuar të shesin dinjitetin dhe besimin, shenjtëritë dhe tabanin, për të arritur ndryshimin e kodit të familjes, për të prishur arshin e dashnisë dhe pozitës së naltë, ku Zoti ka vendos prindin: Nanen dhe Baben, për t'i kthyer ata në numra?!

A kthehet Nana në numër? A kthehet Baba në numër? O bij nanash, o bij baballarësh, a jeni në vete? A jeni njerëz ju?", – tha Myftiu.



I Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë:

"Më të mirët ndër ja janë më të mirët me familjen e tyre!"

(Transmetuar nga Tabaraniu)

DASHURIA DHE EDUKATA NDAJ PEJGAMBERIT (A.S)

"Ne të dërguam ty dëshmitar, përgëzues dhe qortues. Që ju t'i besoni Allahut dhe të dërguarit të Tij dhe atë ta përkrahni e ta respektoni, e (Allahun) ta madhëroni për çdo mëngjes e mbrëmje. Ata që ta japin besën ty, në të vërtetë ata ia japin besën Allahut. Dora e Allahut është mbi duart e tyre. E kush e thyen besën, ai e thyen vetëm në dëm të vetes së tij, e kush e zbaton besën e dhënë Allahut, Ai do t'i japë atij shpërblim të madh". - (Kur'ani, El-Fet'h: 8- 10)

Lavdrim hamja,
Imam - xhamia e "Dy Vajzave"

Është urdhër qiellor dhe detyrë prej Allahut (xh.sh) që çdo mysliman të dojë, të nderojë dhe të respektojë të Dërguarin e Allahut, Pejgamberin (a.s). Për këtë kemi argument ajetin kuranor, ku Allahu (xh.sh) thotë: "Ne të dërguam ty dëshmitar, përgëzues dhe qortues. Që ju t'i besoni Allahut dhe të dërguarit të Tij dhe atë ta përkrahni e ta respektoni, e (Allahun) ta madhëroni për çdo mëngjes e mbrëmje. Ata që ta japin besën ty, në të vërtetë ata ia japin besën Allahut. Dora e Allahut është mbi duart e tyre. E kush e thyen besën, ai e thyen vetëm në dëm të vetes së tij, e kush e zbaton besën e dhënë Allahut, Ai do t'i japë atij shpërblim të madh". - (Kur'ani, El-Fet'h: 8- 10)

Allahu i madhëruar na e dërgoi Pejgamberin (a.s) që të jetë dëshmitar i jonë dhe të na përgëzojë, ndërsa tua tërheq vëmendjen atyre që largohen nga rruga e tij dhe nuk e pasojnë atë. Gjithashtu Allahu kërkon prej nesh që ta përkrahim dhe ta respektojmë në mënyrën dhe formën e duhur.

Si të mos e përkrahim, të mos e duam dhe të mos e respektojmë kur ai është më i dashur dhe më i dhembshur për ne, se sa ne për vetët tona. A nuk thotë Zoti i madhëruar në Kur'an, duke na treguar se si Pejgamberi (a.s) ndjen dhembshuri dhe keqardhje për ne?

"I dërguari i do më shumë besimtarët, se sa ata veten e tyre. Gratë e tij janë nënat e tyre". - (Kur'ani, El-Ahzabë: 6)

Përsëri Zoti i madhëruar thotë: "Juve ju erdhi i dërguari nga mesi juaj. Atij i vjen keq për vuajtjet tuaja dhe ndjen dhembshuri për ju. E ai për besimtarët është i butë dhe i mëshirshëm". - (Kur'ani, Et-Teube: 128)

Ky është Pejgamberi (a.s), i cili na donte aq shumë, saqë asnjëherë nuk e largonte mendjen nga ymeti i tij. Ky është i Dërguari i Allahut, i cili po lexonte në Kur'an fjalët e Ibrahimit (a.s) dhe të Isait (a.s) dhe tha: O Zoti im, si do të jetë halli i ymetit tim!

Një ditë Pejgamberi (a.s) po lexonte fjalën e Allahut (xh.sh) të Ibrahimit (a.s): "O Zoti im, ata kanë shmangur shumë njerëz (nga rruga e drejtë). Ai që më pason mua, është i fesë sime; e ai që më kundërshton mua, – Ti, pra, me të vërtetë, je Falës dhe Mëshirues. - (Kur'ani, Ibrahim: 36)

Dhe lexoi fjalën e Allahut (xh.sh) të Isait (a.s): "Nëse Ti i dënon ata – robërit e Tu janë, e nëse i falë ata, me të vërtetë, vetëm Ti je i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijshëm. - (Kur'ani, El-Maide: 118)

Pejgamberi (a.s) qau dhe Allahu (xh.sh) dërgoi Xhebrailin (a.s) dhe i tha: Pyete Muhammedin, përse po qan? Megjithëse Allahu e di më mirë – zbriti Xhebraili dhe i tha: Çfarë të bën të qash o i Dërguar i Allahut? Tha: Ymeti im, ymeti im, o Xhebrail. U ngjit Xhebraili tek Allahu (xh.sh) dhe i tha: Qan për ymetin e tij, megjithëse Allahu e di më mirë. Allahu (xh.sh) i tha Xhebrailit: Shko te Muhammedi dhe thuaj se Ne do ta bëjmë të jetë i kënaqur për ymetin e tij."- (Transmetuar nga Muslimi)

Si të mos e duam dhe të mos e respektojmë dhe të mos e nderojmë



"Askush nuk ka qenë më i dashur dhe më i nderuar në sytë e mi për mua, se sa i Dërguari i Allahut (a.s). Asnjëherë nuk i kam ngopur sytë duke e shikuar, në shenjë respekti ndaj tij. Sikur të më thotë dikush që ta përshkruaj të Dërguarin e Allahut, nuk do të mund, sepse asnjëherë nuk i kam ngopur sytë duke e shkuar"!

të Dërguarin tonë (a.s), i cili edhe në momentet e fundit të jetë së tij qante dhe thoshte: "Sa më ka marrë madhi për vëllezërit e mi!". Njerëzit e pyetën: A nuk jemi ne vëllezërit e tu? Tha: "Jo, ju jeni shokët e mi, ndërsa vëllezërit e mi janë njerëz, të cilët do të vinë pas meje, më besojnë mua, por pa më shikuar me sy".

Por, si ta duam dhe ta nderojmë Pejgamberin (a.s)? Atëherë, le të marrim shembull prej shokëve të tij, të cilët e deshën, e nderuan, e respektuan, e përkrahën dhe e mbështetën në atë mënyrë dhe formë, që sado ne të mundohemi kurrë nuk do të mundemi të bëjmë sa kanë bërë sahabet për Pejgamberin (a.s).

Ja disa shembuj nga jeta e tyre.

Transmetohet nga Amër ibn Al-As (r.a) se ka thënë: "Askush nuk ka qenë më i dashur dhe më i nderuar në sytë e mi për mua, se sa i Dërguari i Allahut (a.s). Asnjëherë nuk i kam ngopur sytë duke e shikuar, në shenjë respekti ndaj tij. Sikur të më thotë dikush që ta përshkruaj të Dërguarin e Allahut, nuk do të mund, sepse asnjëherë nuk i kam ngopur sytë duke e shkuar!" - (Transmetuar nga Muslimi)

Kur Pejgamberi (a.s) dërgoi Othmanin (r.a) të negociojë me kurejshitët në ngjarjen e Hudejbijes, ata i dhanë leje Othmanit (r.a) të bëjë tavaf përreth Qabes, ndërsa ai refuzoi dhe tha: Asnjëherë nuk do të bëj tavaf, pa e bërë më parë i Dërguari i Allahut (a.s).

Enes ibn Maliku (r.a) tregon se: Dyert e Pejgamberit (a.s) trokiteshin me thonj (si respekt ndaj tij për të mos e shqetësuar, ose bezdisur).

Ndërsa kur dikush e pyeti Abasin (r.a): Kush është më i madh, ti apo i Dërguari i Allahut? Ai tha: Ai është më i madh, por unë kam lindur përpara tij!

Një ditë Omeri (r.a) i tha Pejgamberit (a.s): O i Dërguar i Allahut, ti je më i dashur për mua, se çdo gjë tjetër, përveç vetes time. Pejgamberi (a.s) i tha: "Jo pasha Atë që shpirti im është në dorën e tij, derisa të jem më i dashur për ty edhe se nga vetja jote." Omeri tha: Tani ti je, pasha Allahun më i dashur për mua edhe se vetja ime. Pejgamberi (a.s) i tha: "Tani po, o Omer!"

Ja çfarë edukate dhe dashurie kishin shokët e Pejgamberit (a.s) me të Dërguarin e Allahut! A jemi ne në gjendje të ecim në rrugën e tyre, duke u sjellë mirë dhe me edukatë ndaj Profetin tonë (a.s). A dëshirojmë të fitojmë shefatin e tij, faljet e tija, qëndrimin në xhenet pranë tij, dhembshurinë, butësinë, mëshirën dhe dëshminë e tij në ditën e kiametit se jemi prej ymetit të tij?

Sigurisht që është e vërtetë se Pejgamberi (a.s) nuk është më sot i gjallë mes nesh, por ne përsëri kemi mundësi dhe duhet ta respektojmë dhe të sillemi ndaj tij, ashtu siç janë sjellë sahabet me të.

Dhe mënyra e vetme është ta duam dhe ta pasojmë atë në të gjithë jetën tonë. Të biem sa më shumë salavat për mbi të dhe të punojmë sa më shumë prej suneteve të tij.

Prandaj, le të fillojë që sot, të ecim në këto porosi, ku ai ka thënë:

Ebu Hurejrete (r.a.) transmeton se Pejgamberi (a.s.) ka thënë: "Besimi (Imani) është shtatëdhjetë e ca pjesë, edhe turpi është prej besimit". - (Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi)

Ebu Musa (r.a.) transmeton se disa shokë thanë: O i Dërguar i Allahut! Cili Islam është më i mirë? Pejgamberi (a.s.) tha: "Prej të cilit myslimanët janë të qetë prej gjuhës dhe dorës së tij". - (Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi)

Abdullah ibn Mes'udi (r.a.) transmeton se Pejgamberi (a.s.) ka thënë: "Ofendimi (sharja) e myslimanit është fisk (mëkat), ndërsa vrasja e tij kufr (mosbesim)". - (Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi)

Ibn Umeri (r.a.) transmeton se Pejgamberi (a.s.) ka thënë: "Mjerë për ju, mjerë për ju, mos u ktheni pas meje jobesimtarë, duke goditur dhe vrarë njëri-tjetrin". - (Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi)

Allahut i Madhëruar na bëftë prej pasuesve të denjë të Pejgamberin tonë të dashur, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të!

ISHTE I MADH PËRPARA SE TË NGJITEJ... DHE MBETI I MADH EDHE PASI ZBRITI..!

Dr. Mustafa Mahmud
(1921 - 2009)

"Kujto, se Muhammedi u ngjit në qiellin e shtatë, mbërriti deri tek Sidretul-Munteha dhe u afrua deri atje sa nuk ishte afruar asnjë krijesë tjetër përpara tij. Dhe, kur u kthye në tokë ai ishte në shërbim të familjes së tij, mjelte dhëntë dhe qepte këpucët e tij. I vinte skllavi duke i kërkuar të ndërmjetësojë tek zotëria i tij, e ashtu vepronte. I vinte skllavja e vogël dhe e tërhiqte për dore, që të ndërmjetësojë për të tek familja e saj dhe shkonte me të tek ata. U ngjit në qiellin e shtatë dhe vazhdoi të hante në një sahan të vetëm me të varfërit dhe udhëtonte me mushkë. Urdhëronte ushtrinë e tij të mos priste asnjë pemë, të mos vrisnin fëmijë e as gra, dhe t'i linin murgjërit në manastiret e tyre e çfarë adhuronin ata. Ishte i madh përpara se të ngjitej... dhe mbeti i madh edhe pasi zbriti. I madh pa mendjemadhësi dhe madhështor pa madhështi!"

VEPRA QË TREGOJNË, SE NE E DUAM PEJGAMBERIN (A.S)

Naim Drijaj,
Imam - xhamia e Parrucës

Allahu (xh.sh) e lartësoi përmendjen e emrit të Muhammedit (a.s) përkrah emrit të vet në Fjalën e Dëshmisë, në Ezan, në Ikamet, në Hutbe e në shumë lutje të tjera. E bëri atë shembull të lartë për njerëzit dhe xhindët dhe e lartësoi atë në gradat më të larta të moralit.

Çfarë duhet të bëjmë, që ta shtojmë dashurinë ndaj Pejgamberit (a.s) dhe ta meritojmë shefatin e tij? Më poshtë po sjellim disa gjëra, të cilat na afrojnë më shumë, nga i Dërguari i Allahut (a.s).

1. Leximi dhe studimi i jetës së tij. Sa më shumë që njeriu e studion jetën e Muhammedit (a.s) aq më shumë do ta dojë atë. Njeriu e përmend shpesh atë që do dhe në çdo rast përpiqet të flasë me dashuri për të, duke treguar për virtytet e tij. Sa herë që përmend atë që e do, duke vënë në dukje cilësitë e tij të mira, të shtohet edhe më shumë dashuria për të.

2. Pasimi i tij. Ne duhet që ta ndjekim dhe ta pasojmë atë në çdo fjalë, vepër, sjellje dhe qëndrim të tij. Të mundohemi që jetën tonë ta jetojmë në përputhje me sunetin e tij. Allahu i Madhëruar thotë: "Ndiqeni rrugën e tij, që të jeni të udhëzuar!."[1]

Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Kush vepron diçka që nuk është në përputhet me sunetin tim, ajo vepër është e refuzuar."[2] Si shembull më të mirë që tregon për pasimin e Pejgamberit (a.s) është rasti i Omerit (r.a) i cili iu afrua gurit të zi në Qabe, e puthi dhe tha: "Pasha Allahun, unë e di që ti je vetëm një gurë; as nuk bën dëm e as dobi. Sikur të mos e kisha parë të Dërguarin e Allahut duke të puthur, as unë nuk do të të kisha puthur."[3]

3. Shpeshtimi i salavateve. Salavatet ndikojnë që në zemër të besimtarit të shtohet dashuria ndaj të Dërguarit të Allahut. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Kush më dërgon mua salavat një herë, Allahu i dërgon atij salavat dhjetë herë."[4] "Njeriu më i afërt me mua në ditën e Kiametit është ai, i cili më ka dërguar më shumë salavate".[5] "Koprrac i vërtetë është ai, i cili e dëgjon emrin tim dhe nuk bie salavate për mua".[6]

4. Përmallimi për tu takuar me të. Ebu Bekri (r.a) derisa ishte gjallë i Dërguari i Allahut edhe pse vazhdimisht e shoqëronte atë, ai përsëri ndjente mall për të. Kurse pas vdekjes së tij ky mall do të shtohej edhe më shumë. Ja si i përshkruan emocionet dhe mallin e Ebu Bekrit (r.a) për takimin me Pejgamberin (a.s), e bija e tij, Aishja (r.anha): "Babai kur ishte në shtratin e vdekjes më pyeti: Çfarë dite është sot!" "E hënë", iu përgjigja. Ai i emocionuar më tha: "Nëse ndërroj jetë sot, mos e vononi varrimin tim deri nesër, ngaqë, për mua dita më e dashur është dita kur jam afër të Dërguarit të Allahut" (domethënë çasti kur do të takoj atë).[7]

Në çastet e vdekjes së Bilalit (r.a), gruaja e tij qante dhe thoshte: "Mjerë për mua!", por Bilali i thoshte: "Mos thuaj kështu, por thuaj: "Lum burri im që po vdes, ngaqë do të takohet me të dashurit e tij, me Profetin (a.s) dhe shokët e tij".[8]

5. Mësimi i Kuranit dhe hadistheve të tij. Uthaman ibn Afani (r.a) tregon, se i Dërguari i Allahut ka thënë: "Më i miri prej jush është ai, i cili e mëson Kuranin dhe ua mëson atë të tjerëve".[9] I kanë thënë Abdullah ibn Mubarekut: "Deri kur do të dëgjosh dhe do të mësosh hadithe?" "Deri në vdekje."- I tha.[10]

Një grup nxënësish e vizituan Sufjan Eth-Theuriun, i cili ishte i sëmurë në prag të vdekjes. Gjatë vizitës, duke biseduar, dikush nga të pranishmit transmetoi një hadith. Hadithi tërhoqi vëmendjen e imamit, i cili nxori një tabak letre dhe filloi ta shënonte hadithin. Të pranishmit u habitën dhe i thanë: "Edhe në këtë gjendje që je po shkruan?" Imami u përgjigj: "Dëgjova diçka të bukur. Edhe nëse vdes, unë kam shënuar diçka të dobishme!"[11]

Seid ibn El-Musejib, një nga dijetarët e Tabiinëve, ka thënë: "Arrija të udhëtoja me ditë e me net, me qëllim që ta dëgjoja një hadith."[12]

6. Të duam ata që ka dashur Muhammedi (a.s), sahabët e tij. Sahabët ishin njerëzit që e kanë dashur të Dërguarin e Allahut (a.s) më shumë se kushdo tjetër. Ata sakrifikuan për të gjithçka që posedonin, vetën, pasurinë, familjet dhe fëmijët e tyre.

Ata që i urrejnë sahabët gënjejnë që e duan Pejgamberin (a.s) "... Ai që i do ata, i ka dashur nga dashuria që ka për mua dhe ai që i urren ata, i urren nga urrejtja që ka për mua...". [13]

Nga Ebu Seid el-Hudri (r.a) transmetohet se Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Mos i shani sahabët e mi, sepse sikur ndonjëri prej jush të shpenzojë flori sa mali i Uhudit, nuk mund të arrijë qoftë edhe sa grushti i tyre, apo sa gjysma e tij."[14]

Sahabët janë bartësit dhe mbrojtësit e Islamit pas të dërguarit të Allahut. Allahu i zgjodhi ata që të jenë shoqëruesit e të Dërguarit të Tij dhe kumtuesit e fesë së Allahut pas tij. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Njerëzit më të mirë të ymetit tim janë gjenerata ime, pastaj ata që vijnë pas tyre, e pastaj ata që vijnë pas tyre...".[15]

7. Moslakmia e kësaj bote. Ai që e do atë (Pejgamberi a.s), nuk e lakmon këtë botë ngase e di sesi ka jetuar ai. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Allahu më tha të zgjedh ndërmjet të qenurit (Meliken Nebijjen) mbret-pejgamber dhe (Abden Resula) rob-pejgamber. Unë zgjodha (Abden Resula) rob-pejgamber."[16]

Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Kushdo që e ka për qëllim ahiretin, Allahu do ta bëjë të pasur në zemër, do t'ia pakësojë problemet e kësaj bote dhe të mirat e kësaj bote do t'i vijnë edhe pse ai nuk i ka synuar...".[17]

Hasan El-Basriu ka thënë: "Allahu e mëshiroftë atë popull, ku dynjanë e kuptojnë si amanet për ta dhe në fund ia dorëzojnë amanetin pronarit të saj!"

8. Luftimi i bidateve dhe çdo gjëje që cenon sunetin e Pejgamberit (a.s). Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Fjala më e mirë është Fjala e Allahut, Libri i Tij; rruga më e mirë është udhëzimi i Muhammedit (Suneti i tij); puna më e keqe është risia (bidati në fe) dhe çdo risi është humbje, devijim."[18]

Imam Maliku ka thënë: "Brezat e fundit të ymetit udhëzohen me çfarë është udhëzuar edhe brezi i parë i këtij ymeti. Prandaj çfarë nuk ishte pjesë e fesë atëherë, as sot, nuk është pjesë e saj."[19]

Muhammed ibn Axhlan ka thënë: "Vepra pranohet vetëm me tre kushte: Devotshmëria për Allahun, nijeti i mirë dhe pajtueshmëria me Sunetin."[20]

Fudejl ibn Ijad ka thënë: "Ndiq rrugët e udhëzimit dhe mos u shqetëso nga ndjekësit e pakët. Ruaju, largohu nga rrugët e bidatit dhe mos u mashtro me ndjekësit e shumtë."[21]

E vërteta nuk matet me sasinë e njerëzve, por më fuqinë e argumentit.

Pse duhet ta duam Muhammedin (a.s)?

Ne e duam Muhammedin (a.s) ngaqë është pikërisht ai që na njohu me Zotin tonë të dashur; ngaqë është pikërisht ai i zgjedhuri i Zotit për të qenë përcjellës i Mesazhit të Tij te njerëzit. Ai solli Kuranin, mrekullinë më të madhe që i dhuroi Zoti. Ai na mësoi Islamin, fenë tonë të përkryer. Ai na tregoi se kush është Allahu, çfarë të drejtash ka Ai dhe çfarë detyrimesh kemi ne ndaj Tij. Ai na tregoi se kush e krijoi njeriun, qëllimin përse jeton dhe ku do të shkojë. Ai na mësoi të drejtat dhe detyrimet që kemi në raport me Zotin, me veten dhe me të tjerët. Ai në mësoi se kush i bindet Zotit dhe ndjek rrugën e Tij do jetë i fituar, në këtë botë dhe në botën tjetër. E kush vepron të kundërtën, meriton ndëshkimin në të dy botët, dhe për këtë të mos qortojë askënd veç vetes.

Ne e duam Profetin Muhammed (a.s) sepse me ardhjen e tij ndryshoi rrjedha e historisë së njerëzimit, nga errësirat drejt dritës.

1. Kurani, El-A'raf: 158.
2. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.
3. Transmetuar nga Buhariu.
4. Transmetuar nga Muslimi.
5. Transmetuar nga Tirmidhiu.
6. Transmetuar nga Tirmidhiu.
7. Transmetuar nga Ahmedi.
8. Dhehebiu, Sijer, 1/ 359.
9. Transmetuar nga Buhariu.
10. Miftahu Daris-Seadeh, 1/74.
11. Hiljetul-Evlija, 7/64.
12. El-Xhamiu li Ahlakir-Ravi, 2/226.
13. Transmetuar nga Imam Ahmedi në Musned dhe Tirmidhiu.
14. Transmetuar nga Buhariu.
15. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.
16. Transmetuar nga Imam Ahmedi.
17. Transmetuar nga Tirmidhiu në Sahih el-Xhami.
18. Transmetuar nga Muslimi.
19. Menasikul-Haxh, El-Albani, f. 45.
20. Xhamiu Ulumil-Hikem, f. 10.
21. El-I'tisam, Esh-Shatibi, 1/112.

DHEMBSHURIA E PEJGAMBERIT (A.S) PËR YMETIN E TIJ

Një ditë Pejgamberi (a.s) po lexonte fjalën e Allahut (xh.sh) të Ibrahimit (a.s): "O Zoti im, ata kanë shmangur shumë njerëz (nga rruga e drejtë). Ai që më pason mua, është i fesë sime; e ai që më kundërshton mua, – Ti, pra, me të vërtetë, je Falës dhe Mëshirues.

- (Kurani, Ibrahim: 36)

Dhe lexoi fjalën e Allahut (xh.sh) të Isait (a.s): "Nëse Ti i dënon ata – robërit e Tu janë, e nëse i falë ata, me të vërtetë, vetëm Ti je i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijshëm. - (Kurani, El-Maide: 118)

Pejgamberi (a.s) qau dhe Allahu (xh.sh) dërgoi Xhebrailin (a.s) dhe i tha: Pyete Muhammedin, përse po qan? Megjithëse Allahu e di më mirë – Zbriti Xhebraili dhe i tha: Çfarë të bën të qash o i Dërguar i Allahut? Tha: Umeti im, umeti im, o Xhebrail. U ngjit Xhebraili tek Allahu (xh.sh) dhe i tha: Qan për umetin e tij, megjithëse Allahu e di më mirë. Allahu (xh.sh) i tha Xhebrailit: Shko te Muhammedi dhe thuaj se Ne do ta bëjmë të jetë i kënaqur për umetin e tij."

(Transmetuar nga Muslim)

SENEGALI
OSE REPUBLIKA E SENEGALIT

Senegali, ose Republika e Senegalit, është shtet që gjendet në Afrikën Perëndimore. Ky shtet kufizohet me Mauritaninë në veri, me Malin në lindje, me Guinenë dhe Guinea-Bissau në jug, dhe me Oqeanin Atlantik në perëndim. Në brendësi të tij, Senegali e rrethon shtetin e Gambias nga të gjitha anët, në veri, lindje dhe jug, me përjashtim të bregdetit të shkurtër të atij vendi që kufizohet me Oqeanin Atlantik. Senegali ka një sipërfaqe prej 197,000 km², dhe ka një popullsi prej rreth 17,367, 878 banorësh (Nëntor, 2021, sipas worldometers.info).

Emrin, ky shtet e ka marrë nga lumi Senegal, me të cilin kufizohet në lindje dhe në veri.

Kryeqyteti i vendit, **Dakar**, shtrihet në gadishullin Kepi Verde, që është edhe pika më perëndimore e Afrikës kontinentale.

Senegali është një vend i sheshtë, që shtrihet në ultësirën e njohur si "pellgu Senegalez-Mauritanian". Lartësitë më të mëdha se 100 metra gjenden vetëm në gadishullin Kepi Verde, dhe në juglindje të vendit. Vendi në tërësi ndahet në tre ndarje strukturore: Kepi Verde (i cili formon skajin perëndimor, dhe që përbëhet nga një grup pllajash të vogla, të bëra nga shkëmbinj të fortë me origjinë vullkanike), pjesët juglindore dhe lindore të vendit (të cilat përbëhen nga masive të lashta malore, dhe që janë të ngjitura me ato masive që mbështesin masivin e Futa Dxhalon, në kufirin me Guinenë, ku ky i fundit përfshin pikën më të lartë në vend, që arrin në 581 metra, afër Nepen Diakha), dhe një masë tokësore e madhe por e cekët, që shtrihet midis Kepit Verde në perëndim, dhe skajeve të masivit në lindje.

Bregdeti Atlantik i Senegalit është i ulët dhe me rërë, përveç gadishullit të Kepit Verde, që përbën një breg shkëmbor.

Kufiri verior i vendit formohet nga lumi Senegal, kurse lumenjtë e tjerë të rëndësishëm janë lumenjtë Gambia dhe Kazamanse.

Ishujt e Kepit Verde shtrihen rreth 560 kilometra nga bregu i Senegalit, por Kepi i Gjelbër vetë është i vendosur në këmbët e "Les Mammelles", që është një shkëmb me lartësi 105 metra mbi nivelin e detit, dhe që mbështetet njërin skaj të gadishullit Kepi i Gjelbër, mbi të cilin është vendosur kryeqyteti i Senegalit, Dakar, dhe vazhdon një kilometër në jug të "Pikës së Almadies", që është pika më perëndimore në Afrikë.

KLIMA

Senegali ka një klimë të larmishme, me rajonet e brendshme të karakterizuara nga një temperaturë e lartë, që ndonjëherë arrin në 40 °C, dhe me rajonet bregdetare perëndimore që gëzojnë një temperaturë relativisht të moderuar, që varion midis 17 dhe 25 gradësh në periudhën midis Dhjetorit dhe Qershorit. Sezoni i verës karakterizohet nga reshjet, duke filluar që nga muaji Qershor e deri në muajin

Tetor. Sasia e rreshjeve zvogëlohet sa më shumë që largohemi nga jugu në drejtim të veriut dhe të veriperëndimit, zona në të cilat fillon të dallohet shkretëtira. Senegali ka edhe sezonin e tij të thatë, që zgjat nga Nëntori deri në Qershor. Sasia më e madhe e reshjeve bie në rajonin Kazamanse, dhe varion nga 150 - 180 cm në vit. Sasia e rreshjeve zvogëlohet gradualisht ndërsa shkojmë në veri, derisa pranë lumit Senegal arrin më pak se 50 cm.

EKONOMIA

Senegali është një vend në zhvillim. Kushtet ekonomike atje janë përmirësuar shumë që nga pavarësia (viti 1960). Tre të katërtat e senegalezëve punojnë në bujqësi. Fermat në Senegal prodhojnë mel, oriz, perime dhe kultura të tjera, të gjitha për konsum vendas. Prodhimi i kikirikut konsiderohet si burimi kryesor i të ardhurave në vend. Pambuku dhe rritja e shpendëve janë gjithashtu burime të rëndësishme të ardhurash për fermerët dhe për konsumin lokal. Industria e naftës dhe e derivateve të kikirikut, konsiderohen nga industritë më të rëndësishme në Senegal. Industri të tjera të rëndësishme përfshijnë industrinë e peshkut dhe industrinë e rafinimit të naftës, që importohet nga Algjeria dhe Gaboni. Fosfati i nxjerrë nga guri gëlqeror, konsiderohet minerali më i rëndësishëm në Senegal.

Pjesa më e madhe e shkëmbimit tregtar të Senegalit bëhet me Francën, e cila është partnerja kryesore e tij, që nga shekulli i nëntëmbëdhjetë, siç ka gjithashtu lidhje tregtare edhe me vende të tjera në Afrikë. Tre të katërtat e tregtisë së jashtme të Senegalit zhvillohen përmes portit të Dakarit, që është një nga portet më të mëdha të Afrikës.

GJUHA

Në Senegal fliten rreth 39 gjuhë. Frëngjishtja është gjuha zyrtare e Senegalit, dhe flitet nga të gjithë ata që kanë patur fatin të ndjekin disa vite në sistemin arsimor, i cili është me origjinë franceze. Megjithatë, shkollat e Kuranit janë më popullore në Senegal, gjë e cila ka sjellë njohjen e gjuhës Arabe atje. Gjuhëtarët i ndajnë gjuhët afrikane që fliten atje në dy familje: Atlantike dhe Mande. Familja Atlantike, e gjetur përgjithësisht në gjysmën perëndimore të vendit, përmban gjuhët që fliten më gjerësisht në Senegal: Wolof, Serer, Fula dhe Diola. Gjuhët Mande gjenden në gjysmën lindore dhe përfshijnë ato: Bambara, Malinke dhe Soninke.

FEJA

Feja Islame përfshin më shumë se 95 % të popullsisë së Senegalit. Krishterimi përbën rreth 4.1% të popullsisë, ku shumica e ndjekësve janë katolikë romakë, kurse numri i vogël i protestantëve që ekzistojnë atje, janë kryesisht emigrantë nga Evropa. Pjesa e mbetur e popullsisë ndjekin besimet animiste.

HISTORI

Gjetjet arkeologjike në të gjithë zonën e Senegalit tregojnë se vendi ka qenë i banuar në kohët parahistorike, dhe ka qenë vazhdimisht i pushtuar nga grupe të ndryshme etnike. Atje u krijuan disa mbretëri përgjatë shekujve, si perandoria Takrur në shekullin e 9-të, perandoria Namandiru dhe perandoria Xholof gjatë shekujve 13 dhe 14. Senegali Lindor dikur ishte pjesë e perandorisë së Ganës.

Midis viteve 1300 dhe 1900, në rajonin e Senegambisë (kështu u emërtua bashkimi i Senegalit me Gambian), afër një e treta e popullsisë ishte skllavëruar, zakonisht si rezultat i kapjes rob në luftë.

Në shekullin e 14-të, perandoria Xholof u bë më e fuqishme, pasi kishte bashkuar mbretërinë Kajor dhe mbretëritë e Baol, Siné, Salum, Walo, Futa Toro dhe Bambuk, ose një pjesë të madhe të Afrikës Perëndimore të sotme. Kjo perandori ishte një konfederatë vullnetare e shteteve të ndryshme. Perandoria Xholof u themelua nga Ndiadiane Ndiaje, dhe u rrëzua rreth vitit 1549.

Në mesin e shekullit të 15-të, portugezët zbarkuan në vijën bregdetare të Senegalit, të ndjekur nga tregtarë që përfaqësonin vende të tjera, përfshirë francezët. Fuqi të ndryshme evropiane - Portugalia, Holanda dhe Britania e Madhe - konkurruan për tregtinë në zonë, nga shekulli i 15-të e më pas.

Në vitin 1677, Franca fitoi kontrollin mbi atë që ishte bërë një pikë e vogël tregtie skllevërish në Atlantik. Bëhet fjalë për ishullin Gorée, pranë Dakarit

Kryeqyteti, Dakar

modern, i cili përdorej si bazë për të blerë skllevër nga krerët ndërluftues në kontinent. Në vitet 1850, francezët filluan të zgjeroheshin në tokën senegaleze, duke përfshirë mbretëritë vendase si perandoritë Walo, Kajor, Baol dhe Xholof. Kolonialistët francezë pushtuan progresivisht, dhe i pushtuan të gjitha mbretëritë, (përveç Siné dhe Salum), nën drejtimin e guvernatorit Louis Faidherbe.

Më 25 nëntor të vitit 1958, Senegali u bë një republikë autonome, brenda Komunitetit Francez.

Në janar të vitit 1959, Senegali dhe Sudani Francez u bashkuan për të formuar Federatën Mali, e cila u bë plotësisht e pavarur më 20 qershor 1960, si rezultat i një marrëveshjeje për transferimin e pushtetit, të nënshkruar me Francën më 4 Prill të vitit 1960. Për shkak të konflikteve të brendshme politike, më 20 Gusht të vitit 1960 Federata u nda, dhe Senegali e Sudani Francez (i riemërtuar Republika e Malit) shpallën secili pavarësinë e vet.

Léopold Sédar Senghor, poet, politikan dhe burrë shteti i njohur ndërkombëtarisht, u zgjodh presidenti i parë i Senegalit.

SI HYRI ISLAMI NË SENEGAL

Informacioni më i saktë që mbështetet në argumente dhe në dëshmi historike është se Islami ka hyrë në Senegal nëpërmjet Almoravidëve, me lëvizjen e Abdullah ibn Jasinit, në shekullin e 11-të hixhrij. Pas Abdullah ibn Jasinit dhe lëvizjes së tij, pati senegalezë që mësuan nga këta mbartës të Islamit, e përqafuan fenë islame, dhe filluan lëvizjen e tyre për promovimin e fesë në pjesën tjetër të vendit. Disa nga këta ishin edhe Haxhi Omer El-Futi dhe Haxhi Maliki, të cilët punuan për hapjen e fesë në të gjithë vendin.

Mbretëria Futa Toro, ose Imamati Futa Toro, në Senegal, që ndodhej në brigjet e lumit Senegal, dallohet nga rajonet e tjera senegaleze sepse është zona e parë atje që u njoh me Islamin. Aty u ngrit qeveria e parë islame, që zbatonte ligjin e Zotit të madhërishëm. Nga mirësitë e sistemit të Imamatit ishte përhapja e Islamit, kujdesi për xhamitë dhe nxitja e tubimeve të diturisë. Vlen të citohet këtu, me plot krenari, ajo që ka shkruar një nga kolonizatorët bashkëkohorë të Imamatit, Petioni, në lidhje me ndalimin e imamëve të Futës praktikimin e skllavërisë në mbretërinë e tyre, pasi kjo bie ndesh me parimet e Islamit, e një nga ato parime është edhe thënia: "Që kur i robëruat njerëzit ju, ndërkohë që nënat e tyre i kanë lindur ata të lirë?!". Petioni shkroi: "Imami, mbreti i Polit, i refuzoi dhuratat e kompanisë (së tregtisë së skllevërve), duke ndaluar shitjen e nënshtetasve të tij, dhe duke ndaluar kalimin e karvanëve të skllevërve andej.".

Futa ka mbajtur amanetin e përhapjes së Islamit në krahinat fqinje të saj. Kjo zonë gjithashtu është ajo që i ka dhënë Senegalit personalitetet më të rëndësishme fetare dhe intelektuale, që nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë e deri në çerekun e parë të shekullit aktual, personalitete të tilla si: Omer El-Futi, Maba Jakhuba, Malik Si, Ahmed Bamba, etj.

KUSH ISHTE ABDULLAH IBN JASIN, DHE SI U FORMUA LËVIZJA ALMORAVIDE

Abdullah ibn Jasini ka qenë udhëheqësi i parë i Almoravidëve. Ai i bashkoi ata dhe ishte themeluesi i thirrjes reformiste në mesin e tyre, dhe ka qenë një nga dijetarët e shkollës Maliki. Ai cilësohet të ketë qenë një student i zgjuar, inteligjent, fisnik, një

12

Xhamia e madhe, qyteti Touba

njeri i fesë dhe i virtytit, i devotshëm, modest, dijetar fetar, letrar, njohës i politikës, dhe kërkues i shkencave të ndryshme. Dhehebiu (dijetar i shquar musliman), thotë kështu për Abdullah ibn Jasinin: “Ai ka qenë një dijetar me shpirt të fortë, me vizion dhe me aftësi të mëdha menaxhuese.”

Shejhu Abdullah ibn Jasin u nis nga Maroku, drejt shkretëtirës së madhe, duke depërtuar në Algjerinë jugore dhe në Mauritaninë veriore, derisa arriti në jug të Mauritanisë, atje tek fisi Xhudale, ku toka ishte djerrë dhe nxehtësia ishte e madhe. Njerëzit asokohe ishin zhytur në një injorancë të vajtueshme, kështu që ai filloi t’u mësojë atyre vlerat njerëzore dhe virtytet, duke i mësuar ata për punë të mira, dhe duke i ndaluar nga të pahijshmet.

Liderët e popullit atje dhe palët e interesuara u revoltuan kundër tij, kështu që njerëzit filluan të debatojnë me të dhe ta pengojnë nga ajo që bënte.

Jahja ibn Ibrahim El-Xhudali, që ishte udhëheqësi i fisit Xhudale, nuk qe në gjendje ta mbronte atë, megjithatë shejh Abdullah ibn Jasin nuk u dëshpërua, por u përpoq vazhdimisht në misionin e tij. Ata e rrahën dhe e ofenduan, pastaj e kërcënuan me dëbim nga vendi ose me vrasje, por qëndrimi i Shejhut vetëm sa forcohej. Ditët kalonin dhe ai vetëm i thërriste njerëzit në rrugën e drejtë... dhe më në fund, ata e përzunë vërtet nga Xhudale.

Abdullah ibn Jasin, pasi e mendoi gjatë çështjen, Zoti i tij e udhëzoi atë, kështu që ai shkoi thellë në shkretëtirë... në anën jugore ... larg në thellësitë e kontinentit afrikan, derisa arriti në një ishull që ka të ngjarë të gjendet në kthesën e lumit Niger, afër qytetit Timbuktu. Nga këtu filloi çështja e Almoravidëve. Historiani i famshëm, Ibn Khaldun, e përshkruan këtë ishull duke thënë: “Ai është i rrethuar nga lumi. Në verë është i cekët dhe kalohet me këmbë, kurse në dimër është plot, dhe kalohet me varka.”

Atje, Abdullah ibn Jasin ngriti një tendë të thjeshtë ku të strehohej. Ishte e natyrshme që në Xhudale të kishte njerëz – veçanërisht nga të rinjtë - zemrat dhe natyrat e pastra të të cilëve të ishin ndikuar nga fjalët e tij. Kur ata e morën vesh për vendin e largët ku qëndronte mësuesi i tyre, ata shkuan pranë tij, nga jugu i Mauritanisë. Në fillim ata nuk ishin më shumë se shtatë vetë nga Xhudale, dhe në krye të tyre ishte princi Jahja ibn Ibrahim El-Xhudali, i cili la popullin dhe postin e tij të rëndësishëm që gëzonte mes tyre, dhe shkoi të qëndronte përkrah këtij njeriu të ditur.

Aty në çadrën e tij, dhe me shumë durim dhe këmbëngulje, shejhu Abdullah ibn Jasin filloi t’u mësonte atyre Islamin, ashtu siç Zoti ia kishte shpallur Profetit të tij, Muhammedit, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të, dhe t’u mësonte se si Islami është një sistem gjithëpërfshirës dhe i plotësuar, që i organizon të gjitha çështjet e jetës.

Numri i burrave që vinin për të mësuar atje sa vinte e rritej. Me numrin e madh të tendave, dhe me rritjen e numrit të të ardhurve në pesëdhjetë, pastaj në njëqind, pastaj në njëqind e pesëdhjetë, pastaj në dyqind... shejhut iu bë e vështirë t’ua komunikonte personalisht njohuritë e tij të gjithëve, kështu që ai i ndau ata në grupe të vogla, ku secilit grup i caktoi kryetar një nga më të talentuarit, dhe kjo ka qenë edhe metoda e të Dërguarit të Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, kur ulej me sahabet në Mekë dhe u mësonte atyre Islamin. Po ashtu, edhe në besëlidhjen e dytë të Akabesë, i Dërguari i Allahut, alejhi selam, i pati ndarë të shtatëdhjetë e dy burrat që kishin ardhur nga Medina, në dymbëdhjetë grupe, dhe secilit grup u kishte caktuar nga një kryetar, pastaj i kishte dërguar ata sërish në Medinë, derisa muslimanët ndërtuan shtetin e tyre atje.

E tillë ishte edhe metoda e shejhut Abdullah ibn Jasin, derisa në vitin 440 hixhrij (viti 1048 pas Isait a.s), vetëm katër vite pas fillimit të thirrjes së tij dhe migrimit të tij në ishull, numri i ndjekësve të tij arriti në njëmijë vetë, muslimanë... “Ndihmë nga Zoti, dhe fitore e afërt... dhe përgëzoji besimtarët!” - (Kurani, Es-Saf: 13)

Pasi që ky burrë u përzu, u keqtrajtua ndërsa punonte për hir të Zotit, u rrah dhe u kërcënua me vdekje ai doli i vetëm në thellësitë e shkretëtirës, në veri të Senegalit, pa askënd krah tij, i përzënë dhe i pastrehë... Pastaj, në një kohë jo më shumë se katër vjet, një mijë burra e mësuan prej tij Islamin dhe gjithë çfarë kishte të bënte me të, në mënyrën më të mirë.

Historiani maroken, Ibn Ebi Zer’a, e përshkruan këtë fazë në jetën e Almoravidëve, duke thënë: “Kështu, ai hyri në të (në ishull) dhe me të hynë shtatë persona nga Kedala. Ata ndërtuan aty një Rabita (bëhet fjalë për një qendër ku mblidhen ata që luftojnë në rrugën e Zotit). Ai qëndroi aty me shokët e tij, duke adhuruar Allahun e Plotfuqishëm, për një periudhë prej tre muajsh. Njerëzit dëgjuan për lajmin e tyre, se si ata po përpiqeshin për të fituar xhenetin dhe për shpëtimin nga zjarri, prandaj numri i atyre që vinin tek ata dhe i të penduarve u rrit.

Dashuria për të, për Abdullahun, hyri në zemrat e atyre njerëzve. Nuk kaluan shumë ditë, dhe atij iu mblodhën rreth një mijë burra nga fisnikët e Sanhaxhes, të cilët kishin ardhur si nxënës tek ai, kështu që ai i quajti ata El-Murabitin (Almoravidët – që në arabisht do të thotë: të lidhurit për rrugën e Allahut).

Kjo është historia se si lindi lëvizja e Almoravidëve, të cilët kontribuan në masë të madhe në përhapjen e Islamit në kontinentin e Afrikës.

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, *teologe*

https://www.marefa.org
https://www.britannica.com
https://en.wikipedia.org
https://ar.wikipedia.org
https://midad.com
https://www.dr-mahmoud.com
https://www.islamstory.com/ar/artical

FAMILJA PALESTINEZE I DORËZOI TURQISË AMANETIN E USHTARIT OSMAN, TË CILIN E RUAJTI PËR 106 VJET

Nablus

Familja palestineze Alul i dorëzoi Konsullit të Përgjithshëm të Turqisë në Kuds, ambasadorit Ahmet Rıza Demirer, amanetin me para të mbështjella me një copë leckë, të lënë nga një ushtar osman që shërbente në Palestinë gjatë Luftës së Parë Botërore.

Ekipi i Anadolu Agency (AA) tre vjet më parë kishte raportuar për herë të parë historinë e familjes palestineze, e cila kishte ruajtur më shumë se 100 vjet amanetin e ushtarit osmanë.

- Ata u kujdesën për amanetin e ushtarit osman për 106 vjet

Sipas rrëfimit të Ragip Hilmi al-Alulit, një anëtar i familjes palestineze, fillimi i tregimit shkon në vitin 1915. Në atë kohë, një ushtar osman, i cili u dërgua në një front tjetër nga Palestina gjatë Luftës së Parë Botërore, i mbështolli të gjitha kursimet e tij në një copë pëlhure dhe ia la njërit prej tregtarëve të njohur të qytetit të Nablusit, Rushdi Efendiut.

Për vite me radhë, xhaxhai i Alulit, Rushdi Efendiu, e mbajti amanetin e lënë nga ushtari osman i cili kishte thënë thënë: “Nëse mund të kthehemi, do ta marr”.

Ushtari osman, i cili la paratë dhe identiteti i të cilit nuk dihej, nuk u kthye më në Palestinë, por pas Rushdi Efendiut, nipërit e tij vazhduan të kujdeseshin për amanetin me mendimin se “ndoshta do të kthehet një ditë ose do të vijë një i afërm”.

Në fakt, deri sa ekipi i AA-së bëri lajmin në vitin 2018, ata nuk kishin numëruar as shumën e parave, duke thënë se “amaneti nuk hapet”.

- Monedhat janë nga koha e sundimit të Sulltan Mehmed Reshadit

Shuma të cilën familja e artizanëve të Nablusit e mbron me shumë besnikëri prej vitesh, përbëhet nga dhjetë kartëmonedha gjysmë lire, 117 kartëmonedha një lire dhe pesë kartëmonedha pesë lirash, ose gjithsej 147 lira osmane.

Ana e përparme e monedhave, të cilat nga mbishkrimet në to, mendohet se janë shtypur gjatë sundimit të Sulltan Mehmed Reshadit, gjithashtu ato mbajnë nënshkrimin e Ministrit të Financave të asaj periudhe.

- Ambasadori Demirer e pranoi amanetin me një ceremoni

Fakti që familja Alul e Nablusit mbajti amanetin e një ushtari osman për më shumë se 100 vjet, pati një ndikim të madh në lajmet e AA në vitin 2018.

Familja Alul i dorëzoi ambasadorit Demirer amanetin e ushtarit osman, në një ceremoni të zhvilluar sot në Zyrën e Guvernatorit të Nablusit.

Në ceremoninë ku morën pjesë ambasadori Demirer dhe familja Alul, zëvendësministrja e Punëve të Jashtme palestineze, Emel Jadau, Guvernatori i Nablusit, Ibrahim Raman, kryetari i Nablusit Iyad Halaf, u këndua himni kombëtar turk dhe himni kombëtar palestinez dhe u bënë lutje për dëshmorët.

Në ceremoninë ku u përjetuan momente emocionale, familja Alul i dorëzoi Demirerit amanetin e ushtarit osman me kutinë me flamurin turk dhe palestinez.

Pas ceremonisë, ambasadori Demirer për AA tha se është shumë i emocionuar për marrjen e amanetit të ushtarit osman.

“Është një ditë e rëndësishme për ne, për palestinezët, për vëllazërinë tonë. Sepse ky amanet është një amanet që ka dëshmuar historinë tonë të përbashkët dhe ngjarjet që kemi përjetuar në njëqind vitet e fundit. Ky amanet është këtu për ne dhe tregon se është detyrë nderi për ne që të mbrojmë unitetin tonë përtej vëllazërisë, sepse kjo familje ka 106 vjet që pret me durim që pronari të vijë dhe të marrë amanetin e lënë nga një ushtar turk-osman”, tha Demirer.

Duke theksuar se emri i ushtarit osman ose trashëgimtarëve të tij nuk dihet, Demirer tha: “Sigurisht, meqenëse nuk është e mundur të gjesh vetë (ushtarin osman), të gjesh emrin e tij ose të gjejmë trashëgimtarët e tij, ne si Turqi e marrim përsipër këtë amanet në emër të qeverisë turke dhe ne do ta mbrojmë siç e bënë ata. Ne premtojmë të jemi simbol i këtij amaneti, i kësaj miqësie, i kësaj historie”.

Ai tha se nuk kanë vendosur ende se çfarë do të bëjnë me amanetin në fjalë.

“(Alul) do të vendosë së bashku me familjen e tij. Ata ndoshta do të preferojnë ta ekspozojnë atë në një muze në Turqi. Ne do të respektojmë dëshirën e tyre”.

Duke theksuar se familja Alul është një familje shumë e respektuar në Nablus dhe rreth saj, Demirer i falënderoi ata për ruajtjen e amanetit të ushtarit osman.

- “Ne duam që të ruhet me historinë e tij në muzeun ushtarak turk”

Rageb Hilmi al-Alul deklaroi se historia e amanetit të ushtarit osman u transferua nga gjyshi tek nipi.

Ai u shpreh se historia e këtij amaneti ka tërhequr interesim të madh pas lajmit të AA-së.

“Atëherë u vendos kontakti mes qeverisë turke dhe palestineze për dorëzimin e amanetit që kemi. Ministritë e Jashtme kontaktuan dhe u zhvillua faza përfundimtare”, tha Alul.

Duke thënë se ata do të donin që amaneti t’i dorëzohej një trashëgimtari në rast se gjendet, Alul tha se ky amanet tani është bërë pronë e Turqisë nën mbrojtjen e qeverisë turke dhe i kërkoi qeverisë turke ta ruajë këtë amanet me historinë e saj në muzeun ushtarak turk.

(www.aa.com.tr/sq)

MEVLUDI SHERIFË, GËZIM NË XHAMINË E ZUESIT

Ditën e shtunë, më 6 nëntor 2021, në xhaminë e fshatit Zues u zhvillua aktiviteti i Mevludit Sherifë, që vjen në kuadër të aktiviteteve të larmishme që organizon Myftinia Shkodër në përkujtim të Lindjes së Begatë të Resulullahut (a.s), Muhammedit, paqja dhe mëshira e Zoti qoftë mbi të.

Pas hapjes së këtij aktiviteti me lexim nga Kurani Famëlartë, i ngarkuari për mbarëvajtjen e xhamisë, imami Ridvan Luzaku bëri prezantimin e programit si dhe uroj besimtarët për prezencën e tyre në këtë ceremoni tradicionale.

Në vijim, teologu Arben Halluni, përfaqësuesi i Myftinisë Shkodër mbajti fjalimin e rastit, i cili gjatë bisedës së tij përcolli mjaft mesazhe të rëndësishme me këshilla të dobishme për të pranishmit, të cilëve u bëri thirrje se vetëm shembëlltyra e përkryer e Resulullahut (a.s) është mënyra më e mirë e të jetuarit si besimtarë të devotshëm, të paqtë dhe të mëshirshëm me të gjitha krijesat në këtë tokë të bekuar nga Zoti Fuqiplotë.

Teologu Halluni tha që përkujtimi i i Profetit të Islamit, është përkujtimi i besimit të tij, drejtësisë së tij, humanizimit dhe harmonisë së tij, si dhe të gjitha vetive më të mira morale që Allahu e përzgjodhi sipas parametrave hyjnore dhe jo njerëzore.

Më pas, aktiviteti vijoi me këndimin e disa pjesëve nga të Mevludi, këndim ilahi si dhe recitime nga nxënësit e mejtepit fetar të kësaj xhamie, e cila ishte e mbushur me besimtarë të moshave të ndryshme.

Me faljen e namazit të mesditës dhe më shpërndarjen e disa literaturave islame përfundoi ky aktivitet i dobishëm, për të vijuar karvani i Mevludit Sherifë edhe në xhami të tjera të zonës së Shkodrës.

MYFTIU LIGJËROI PARA MATURANTEVE TË MEDRESESË

Paraditën e së mërkurës, më 10 nëntor 2021, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim të përzemërt me maturantet e Medresesë "Haxhi Sheh Shamia", edhe në kuadër të programit të këshillimit të karrierës.

Gjatë këtij takimi, Imam Sytari u fokusua në katër parime bazë për ndërtimin e një personaliteti shembullor të rinisë islame, duke u bazuar në udhëzimet e Kuranit dhe fjalët e urta të Resulullahut (a.s).

Myftiu ftoi medresistet që të shkojnë përherë pas modeleve elitare në jetë, duke ndjekur rrugën e grave të mëdha e të shquara të historisë së njerëzimit, prej të cilave merret frymëzimi më i mirë për të ardhmen.

Ai tha se synimi i lartësive dhe dëbimi i kompleksit të inferioritetit për shkak të përhapjes së frymërave dekadente të islamofobisë, janë dy rrugë që na shpien drejt kapjes fort pas tabanit tonë islam dhe qëndrimit të lidhur pas zinxhirit tradicional e kombëtar të vlerave tona shekullore!

Për fund, dha një mesazh të rëndësishëm që lidhet me arritjen e përsosmërisë në çdo fushë që vajzat tona do të vijojnë nesër në vazhdimin e arsimimit dhe ndjekjen e universiteteve më të mira, kudo nëpër botë!

Aktiviteti u përshëndet edhe nga drejtori i Medresesë, Kujtim Dervishi dhe koordinatorja e degës së vajzave, Elona Sytari, sikurse u shoqërua edhe me pyetje të ndryshme nga maturantet.

AKTIVITET PËRKUJTIMOR, 31 VJET SI SOT, NË XHAMINË E PLUMBIT...

Paradreken e të martës, më 16 nëntor 2021, në xhaminë e Plumbit u zhvillua një aktivitet përkujtimor në ditën e shënuar historike të ceremonisë madhështore të rihapjes së xhamisë së Plumbit, më 16 nëntorit 1990.

Besimtarë të shumtë, imamë dhe drejtues të institucioneve islame, kishin ardhur për të falur fillimisht namazin e drekës në xhaminë e Plumbit. Më pas, në oborrin e xhamisë u mbajt një tubim përkujtimor me përshëndetje, mesazhe dhe kujtime mallëngjyese për këtë ditë të madhe historike, ku jehona e saj vazhdon të përkujtohet akoma edhe sot, pas 31 viteve.

Në fjalën e tij, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, u përqendrua tek mesazhet e kësaj ngjarjeje dhe rëndësinë që ka përkujtimi i datave të shënuara të historisë së shpirtit, ku e cilësoi ditën e 16 nëntorit 1990, si Dita e Rimëkëmbjes Islame në vendin tonë.

Myftiu vlerësoi frymën e atyre ditëve, ku i madh dhe i vogël ishin aty, për të mundësuar dëshmimin e thirrjes së shpirtit t'u liruar nga prangat dhe vargonjtë e periudhës më të errët të historisë shqiptare.

Ai kërkoi që besimtarët të luten për shpirtin e Hafiz Sabri Koçit dhe bashkëpunëtorëve të tij, sikurse tha se shoqëria duhet të ngrihet për të mos e pranuar zullumin dhe të keqen, që përhapet kudo dita-ditës.

Myftiu Sytari tha se prej mirësive të kësaj ditë të shënuar është edhe thirrja për të parë se ku jemi dhe sfidat, me të cilat përballemi si shoqëri, ku dha një mesazh të fortë për ruajtjen e familjes dhe mos tolerimin e përpjekjeve shterpë për të prishur tabanin shekullor të saj.

Në lidhje me premtimin e bërë nga presidenti i Republikës së Turqisë, Rexhep Tajjip Erdogan për xhaminë e Plumbit, Myftiu u shpreh se duhet të kemi pak durim dhe të mbajmë shpresën gjallë se së shpejti do të zbatohet projekti i madh dhe shumë i mirëpritur për rikonstruksionin e xhamisë së Plumbit, i cili do të marrë formën e plotë dhe të sigurt, siç i takon dhe e meriton kjo zonë shekullore islame.

Në vijim, njëri ndër nismëtaret për rihapjen e kësaj xhamie, Mehdi Myftia tregoi para të pranishmëve përpjekjet e tij dhe të bashkëkohësve të tij për rihapjen e xhamisë.

Ai tha se më 16 nëntor 1990 këtu u mblodhën besimtarë jo vetëm nga Shkodra, por nga e gjithë Shqipëria, nga qytetet dhe fshatrat e vendit. Njëkohësisht përmendi edhe përpjekjet e organizimit të madh, që nisën që më 5 nëntor dhe u finalizuan me ceremoninë madhështore të 16 nëntorit 1990.

Ai tha se sistemi i asaj kohe na kërcënonte me burgim, popullsinë, besimtarët, por edhe neve që ishim si nismëtare të rihapjes së xhamisë për t'i shërbyer besimtarëve. Edhe pse policia na pengonte dhe kishte rrethuar xhaminë ne nuk u ndalëm në misionin që i kishim vënë vetes - tha ndër të tjera njëri prej nismëtarëve Myftia.

Në fund të kësaj veprimtarie përkujtimore, të gjithë të pranishmit vizituan dhe bënë nga një foto në zonën tjetër historike, në vakëfin e xhamisë së Tabakëve, që ndodhet pranë xhamisë së Plumbit.

NË MËSHIRËN E ALLAHUT, H. BLEDAR SULEJMANI

"Ne jemi të Allahut dhe tek Ai kthehemi"

Pas një sëmundjeje të gjatë, ditën e shtunë, më 20 nëntor 2021, ka ndërruar jetë në Francë, vëllai dhe kolegu jonë, H. Bledar Sulejmani (Allahu e mëshiroftë).



H. Bledar Sulejmani lindi, më 9.6.1982 në fshatin Guri i Zi, Shkodër dhe mbaroi studimet në vitin 2006, në Damask, Siri, në Fakultetin e Thirrjes Islame, pranë Fondacionit "Shejkh Ahmed Keftaro".

Pas diplomimit, kthehet në Shkodër dhe angazhohet në fushën e thirrjes islame dhe shërben si imam dhe hatib në disa xhami, ku më tepër shërbeu në xhaminë e fshatit Bardhaj.

Para disa vitesh, familja e tij, detyrohet të emigrojë në Francë me qëllim të trajtimit më të mirë të sëmundjes së tij, por kaderi i Zotit e kishte shkruar të ndërrojë jetë në vend të huaj.

Sipas lajmërimit të familjes së tij, varrimi do të bëhet në Francë dhe xhenazja do t'i falet, ditën e martë më 23 nëntor 2021, pas namazit të drekës (ora. 13.00).

Familjarët e tij në fshatin Gur i Zi, presin ngushëllime në shtëpinë e tyre, nga dita e mërkurë deri ditën e diel (24-28 nëntor 2021).

Në shenjë nderimi dhe respekti për vëllanë dhe kolegun tonë, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, ka dhënë udhëzim për krejt imamët e Myftinisë Shkodër, që ditën e xhuma, më 26 nëntor 2021, pas faljes së namazit të xhumasë, në të gjitha xhamitë tona të falet namazi i xhenazes në mosprani për shpirtin e rahmetliut.

Allahut të Madhëruar i lutemi ta mëshirojë H. Bledari Sulejmanin dhe ta bëjë prej banorëve të xhenetit!

NGUSHËLLIME DHE LUTJE PËR TË NDERUARIN, H. BLEDAR SULEJMANI

Paraditën e së mërkurës, më 24 nëntor 2021, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i shoqëruar edhe nga një grup imamësh, ishte për ngushëllime në familjen e rahmetliut, H. Bledar Sulejmani, i cili ndërroi jetë në Francë, pas një lëngate të gjatë për shkak të një sëmundjeje të rëndë.

Gjatë ngushëllimeve, Myftiu dhe imamët shprehën mirënjohjen dhe vlerësimet për sakrificën dhe shembullin e imamit të nderuar, që u përkushtua që në moshë të vogël në rrugët e kërkimit të dijes në Damask të Sirisë, pastaj si imam e mësues fetar në xhami të ndryshme të Shkodrës, derisa sëmundja e papritur e ndaloi të vazhdonte misionin e tij.

Myftiu përsëriti udhëzimin e tij drejtuar krejt imamëve të Myftinisë Shkodër, që ditën e xhuma, më 26 nëntor 2021, në të gjitha xhamitë e Shkodrës, do të falet namazi i xhenazes në mosprani, për shpirt të imamit dhe teologut të nderuar, H. Bledar Sulejmani.

TË PARAPRIJË FËMIJA PËR TË TA HAPUR DERËN E XHENETIT!

Kudo që ulej Pejgamberi (a.s), së bashku me të uleshin edhe disa shokë të tij.

Mes tyre ishte një burrë, që kishte një djalë të vogël, që i vinte pas shpine dhe ai e merrte dhe e ulte në prehrin e tij. I vdiq djali këtij burri dhe ai nuk vinte më të ulej në atë ndenje, sepse i kujtohej djali dhe mërzitej për të.

Pejgamberi (a.s) pyeti për të duke thënë: **"Çfarë kam, që nuk e shoh më filanin"?** I thanë: O i Dërguar i Allahut, djali të cilin ia shikoje, i ka vdekur.

Pejgamberi (a.s) e takoi dhe e pyeti për djalin e tij. Ai i tregoi se, i kishte vdekur dhe Pejgamberi (a.s) e ngushëlloi për të, pastaj i tha: **"O ti filan, cila është më e dashur për ty: Të kënaqesh në jetën tënde, apo të vish nesër në ndonjë derë prej dyerve e xhenetit, e ta gjesh atë duke të paraprirë për ta hapur (derën)"?**

Tha: O i Dërguar i Allahut, të më paraprijë në derën e xhenetit e të ma hapë mua atë, është më e dashur për mua.

Pejgamberi (a.s) i tha: **"Ajo të takon"!**

(Transmetuar nga Nesaiu)

MYFTIU I SHKODRËS: "GRATË JANË AMANETI I ZOTIT NË TOKË DHE I KEMI DHËNË BESËN ZOTIT T'I RESPEKTOJMË ATO"

Nga minberi i xhamisë së lagjes Dërgut në qytetin tonë, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, gjatë hytbes së xhumasë më 26 nëntor 2021, u ndal te tematika e pozitës së gruas në Islam që 15 shekuj më parë.

Myftiu tha se figura dhe pozita e gruas duhet të nderohet, respektohet dhe të lartësohet, sepse ato janë amanet i Zotit në tokë dhe porosi e vlerësim i veçantë i Pejgamberit Muhammed (a.s).

"Tërheqja e vëmendjes nga Profeti (a.s), për ta ngritur gruan nga pozita e asgjësë si dhe nga nëndheu, për ta ngritur në qiell të shtatë, është një mirësi dhe bekim i madh, me të cilin ai, i dërguari i Zotit erdhi për të na treguar dhe mësuar fenë e Allahut (xh.sh). Dhe në këtë rrugë i kemi dhënë besën Zotit Madhniplotë për t'i respektuar ato, por edhe për t'u dashur në mesin tonë...".

Imam Muhamed Sytari, në vijim të hytbes bëri thirrje, që të ndahemi një herë e mirë nga modelet e injorancës dhe përpjekjet që bëhen ditë e natë për ta ndarë gruan islame nga morali i fesë dhe pastaj për ta bërë familjen të degraduar e të shthurur, ku ushtrohet dhuna, divorci, shkatërrimi i tabanit të shqiptarit etj, etj.

Kujtojmë se nga xhumaja e datës së 19.11.2021 dhe për tre javë, me udhëzim të Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed Sytari në të gjitha xhamitë e Shkodrës po mbahen predikime dhe ligjërata rreth pozitës së lartë familjes, edukimit të fëmijëve dhe vendit të gruas në Islam, që 15 shekuj më parë, si dhe ndërgjegjësimit të shoqërisë për t'u distancuar nga dhuna në familje, keqtrajtimi i fëmijëve, keqedukimi dhe lënia pas dore e arsimimit të tyre.

MYFTINIA SHKODËR URON 109 VJETORIN E PAVARËSISË

Ditën e diel, më 28 nëntor 2015, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i shoqëruar edhe nga teologët Lavdrim Hamja dhe Arben Halluni, mori pjesë në ceremoninë tradicionale që organizon Bashkia Shkodër me rastin e ngritjes së flamurit kombëtar, në këtë ditë të shënuar të pavarësisë.

Gjatë kësaj ceremonie, Myftiu Sytari uroi fillimisht Kryetaren e Bashkisë Shkodër, znj. Voltana Ademi, Kryetarin e Këshillit të Qarkut Shkodër, z. Hilmi Lakti, Prefekten e Qarkut Shkodër, znj. Majlinda Angoni, Kryetaren e Këshillit Bashkiak, znj. Briselda Kadija, drejtuesit dhe përfaqësuesit e komuniteteve të tjera fetare të Shkodrës, deputetë e drejtues të lartë të administratës etj.

Myftiu me shoqërues u ndalën edhe tek memoriali i komandantit legjendar për mbrojtjen e Shkodrës, Hasan Riza Pasha, ku u lutën për shpirtin e tij dhe të krejt heronjve që ranë për tokën shqiptare.

Myftinia Shkodër uron krejt shqiptarët, kudo ndodhen: Gëzuar 109 vjetorin e Pavarësisë!

MYFTIU: “SHTETI I KUVAJTIT, I DËSHMUAR PËR BAMIRËSI DHE HUMANIZËM!”

Paraditën e së dielës, më 28 nëntor 2021, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në xhaminë e Kirasit në një takim vëllazëror, të ngarkuarin me punë në Ambasadën e Kuvajtit në vendin tonë, z. Halid Esh-Shami, si dhe drejtorin për Ballkanin e “Komisionit për Evropën dhe dy Amerikat”, në Kuvajt, z. Mahmud En-Nexhdi, që shoqërohej edhe z. Samed Shehu, drejtor i Fondacionit “Mirënjohja”.

Pas faljes së namazit të mesditës në kompleksin e ri islam të lagjes Kiras, që i inaugurua më 15 nëntor 2020, falë bashkëpunimit të Myftinisë Shkodër me Fondacionin “Mirënjohja” dhe kontributit të “Komisionit për Evropën dhe dy Amerikat” në Kuvajt, Myftiu dhe miqtë u ndalën tek qendra e jetimëve, ku zhvilluan një takim të përzemërt dhe dhanë mesazhet e ngrohta e vëllazërore, që përkojnë edhe me ditën e pavarësisë.

Gjatë fjalës së tij, Myftiu Sytari shprehu mirënjohjen e thellë për kontributet e Shtetit të Kuvajtit, për bamirësinë dhe humanizmin dhe gjurmët e bardha gjithandej nëpër botë, pa dallime në mesin e njerëzve, si dëshmia më e mirë e një misioni të shtrenjtë e plot vlera!

Nga ana e tyre, edhe miqtë e shtrenjtë dhanë mesazhet e tyre, sikurse ndanë me fëmijët e qendrës gëzimin e kësaj dite dhe mesazhet e mbështetjes së vazhdueshme.

Për nder të miqve, Myftiu shtroi një drekë vëllazërore.

Dr. Ardian Muhaj

“Skënderbeun dhe Ismail Qemalin i ndajnë disa shekuj, por veprat e tyre madhore ngjasojnë si dy pika uje... Në momentin e shpartallimit të shteteve në të cilat ishin pjesë, nxitojnë të kthehen në atdhe, për të mos e lënë tokën e të parëve me ra në duart e grabitqareve... !”

MEJTEPI I IM... XHAMIA ALIMETAJ, ANA E MALIT

Pak histori:

- Xhamia Alimetaj, ndodhet në Njësinë Administrative Ana e Malit, Shkodër.

- Përbëhet prej 75 familjeve myslimane.

- Fiset më të njohura janë: Beqiri, Dehati, Kurti, Ramja etj.

- Me iniciativën e besimtarëve dhe kontributin e të gjithë banorëve si dhe të Myftinisë Shkodër ndërtohet xhamia e re, 2001-2002, në fshatin e ri të zonës së Ana e Malit.

- Në xhaminë Alimetaj nga viti 2002 e deri më sot kanë shërbyer imamë dhe mësues të mejtepeve: Ali Hoxha, Riza Halili, Resmi Likaj dhe imami dhe mësuesi aktual, Lulzim Beqiri.

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar rregullisht rreth 12 kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit, të zhvilluar në xhami në periudha të ndryshme nga viti 2002 -2021 është rreth 190 nxënës dhe nxënëse.

Takimi me nxënësit:

Sektori i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, në vazhdën e vizitave dhe takimeve të me nxënësit e xhamive që frekuentojnë rregullisht kurset-mejtepet e mësim-besimit, më 9 nëntor 2021 drejtuesi i arsimit, teologu Arben Halluni zhvilloi një takim-inspektimi me nxënësit e kursit fetarë në xhaminë Alimetaj.

Fillimisht, teologu Halluni u mbajti një bisedë, duke u përqendruar në rëndësinë dhe vlerën që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që ato mbartin si përçimin te brezi i ri mësimet e vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet të karakterizojë çdo njeri në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit dhe krijesat e Zotit.

Më pas, drejtuesi i arsimit evidentoi ecurinë mësimore të nxënësve, pjesëmarrjen e tyre, procesin mësimor nga mësuesi dhe imami, Lulzim Beqiri.

Gjatë këtij takimi pati edhe pyetje dhe përgjigje rreth njohurive që marrin nxënësit nga ky mejtep fetar.

16 nëntor 1990

Dita e rimëkëmbjes Islame

16 nëntor 2021

"Sot kemi gëzimin më të madh, që pas 23 vitesh, të dëgjojmë kënaqësinë më të madhe të zemrës dhe të shpirtit tonë. Iu hapën portat zemrave, që të njohin, të dashurojnë, të respektojnë më të Afërmin e tyre, i Cili është më afër te njeriu sesa ai te vetvetja, Zotin. **Lavdi të Madhit Zot që e ruajti dashurinë e Tij në zemrat tona e nuk na përbuzi** ... aq më tepër në zemrat e kësaj rinie që sapo del në jetë pa qenë në kontakt me asgjë, ia ndezi dritën e dashurisë së Tij në zemër e në shpirt." - *(Hfz. Sabri Koçi - 16.11.1990)*



MYFTINIASHKODER1990

WWW.MYFTINIA-SHKODER.ORG

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org

Çmimi: 50 lek